

VENDIM
Nr.1059, datë 16.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronës nr.4, në drejtorinë e policisë së qarkut Vlorë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror MB (Drejtoria Policisë së Qarkut Vlorë) Bashkia/Komuna Vlorë Fusha e përdorimit të pronës: Ruajtje rendi											
Nr.rend	A		Emërtesa e pronës vend ndodhja/shtrirja gjeografike	B			C				
	Zona kadastrale indeks hartës	Nr. pasurisë		Komponentët përbërëse të pronës	Adresa/vend ndodhja e komponentëve përbërëse	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
			Drejtoria Policisë Qarku Vlorë								
4				Parku	Jug-perëndim	37	Garazh	Ministria e Brendshme	Drejtoria Policisë qarku Vlorë	Sipas VKM nr.250, datë 24.4.2003 në formularin nr.3, të inventarit të pronave të paluajtshme, të Drejtorisë Policisë Qarkut Vlorë, me numër rendor 4, me emërim “Parku”, me sipërfaqe 625 m ² , janë përfshirë kompleks godinash-magazinë, oficinë, marangoz, kapanon mjetesh,...etj. Sip. e objekteve që do të prishen është 588 m2, (duke rezultuar kjo si sipërfaqe truall e lirë), ndërsa sipërfaqja e objekteve ekzistuese mbetet të jetë 37 m ²	
4/1	Sipërfaqe truall					588					